



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-32269/23 datë:15.12.2023



Npi – 01/458 datë: 27.12.2023

Duke u bazuar në kornizën ligjore si vijon: Neni 11 dhe 12, paragrafi 2, shkronja (c), lidhur me Nenin 17, paragrafi 1, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 6, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Nr.06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019); Nenin 7 të Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes, Nr.09/2020; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Nenin 5 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, si dhe procesit të mbajtur të diskutimit publik me qytetarë, në seancën e rregullt të mbajtur më datën 27.12.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT PRONËN E PALUAJTSHME KOMUNALE

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 27.12.2023, unanimitisht miratoi Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim Pronën e Paluajtshme Komunale.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe diskutimin publik me qytetarë.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi